

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË
“BANESTO LIMITED AL ” SH.P.K**

**TITULLI I
THEMELIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1
THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot më datë 01/10/2021 themeluesit krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nën emërtimin “**BANESTO LIMITED AL** ” sh.p.k, e cila vepron dhe organizohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Ortakët themelues të shoqërisë janë:

Z.Firus Motin Miah, lindur më 03.05.1985 në Cumilla,Bangladesh dhe banues të përkohshëm në Tiranë në adresën: Rr.”Elbasanit”,Pl.2,Ap.26 Tiranë, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse I pasaportës nr. EA0630340,Tel.+355 68 365 6983.

Z.Abdul Ahmed Ali, lindur më 03.10.1966 në Sylhet,Bangladesh dhe banues të përkohshëm në Tiranë në adresën: Rr.”Elbasanit”,Pl.2,Ap.26 Tiranë, dhe rezident ne Spanjë me nr. E22517751,madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse I pasaportës nr. BN0436128; tel. +34 632 70 34 66.

**NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "BANESTO LIMITED AL" sh.p.k është:

1. **Restorant-Bar.**
2. **Prodhimit dhe tregtimit me shumice dhe me pakice të artikujve te tekstilit, te leshta, te te gjitha llojeve, si dhe Import - Ekspert te tyre. Import - eksport, tregtim te artikujve te ndryshem te çdo tipi. Transport per vete dhe per te trete.**
3. **Ushtimi i aktiviteteve në fushën e turizmit dhe udhëtimit dhe transportit turistik.**Organizimi i udhëtimeve dhe pushimeve individuale ose kolektive për qytetarët shqiptarë dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit dhe ndërmjetësimi për shitjen e produkteve turistike në të gjitha format e tij.Organizimi i grupeve ose paketave individuale të udhëtimit, udhëtime dhe pushime për shtetas shqiptarë ose të huaj brenda ose jashtë vendit sipas programeve dhe itinerareve të veçanta, zbatimi i transferimeve, akomodimit dhe shërbimeve të lidhura me to, shitja ose shkëmbimi i biletave të udhëtimit, lehtësimi i transportit të bagazheve dhe prenotimeve vende në mjete të ndryshme transporti, dhe ndërmjetësim për shitjen e të gjitha llojeve të shërbimeve të udhëtimit të produkteve turistike në të gjitha format e tij.Si dhe një agjenci për linjat ajrore, kompanitë e transportit dhe navigimit në shitjen e biletave për klientët e brendshëm, dalës dhe hyrës të drejtpërdrejtë të udhëtimit ose agjencitë e tjera të udhëtimit.Shërbimet që mund të ofrohen në rastin e udhëtimit dhe pushimeve si: Rezervimi i akomodimit në njësitë akomoduese turistike si hotele, lundrime, vila,

from my

bujtina, vendpushime, apartamente etj. Rezervimi dhe shitja e biletave për linjat e navigacionit ajror, tokësor ose detar etj. Rezervimi i vendeve, mjeteve të transportit turistik. Vënia në dispozicion e këtyre automjeteve me qira të pjesshme ose totale. Porositja e ushqimit në restorantet turistike.

NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë **“BANESTO LIMITED AL” SH.P.K** është e pakufizuar. Ajo mund të pushojë veprimtarinë e saj në çdo moment, sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, sipas modaliteteve ligjore.

NENI 4 SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë **“BANESTO LIMITED AL ” SH.P.K.** është në adresën: Rr.”Elbasanit”, Pl.2, Ap.26; Kodi Postar 1010 ; Tirana, Shqipëri. Tel. +355 68 365 6983; E-mail: alinaz1966@yahoo.com.

NENI 5 DEGET, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE PJESMARRJET

Shoqëria në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri ose jashtë saj dhe të fillojë dhe/ose të marrë pjesë në aktivitete të tjera të cdo forme.

TITULLI II KAPITALI, KUOTAT

NENI 6 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është 30 000 (tridhjetë mijë) Euro, i përbërë nga 2 (dy)kuota:

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët e saj si vijon:

1. Ortaku **Z.Firus Motin Miah**, zotëron 1 kuotë që përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë.
2. Ortaku **Z.Abdul Ahmed Ali**, zotëron 1 kuotë që përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7 ÇERTIFIKATAT E KUOTAVE TË KAPITALIT

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zoteron. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

NENI 8 **KALIMI I KUOTAVE ME KONTRATE**

Pjesët/kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe i njoftohet selisë së regjistruar të shoqërisë.

NENI 9

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Ortaku i Vetëm me vendim mund ta zmadhojë kapitalin, duke rritur numrin e kuotave ekzistuese ose duke rritur vlerën nominale të tyre. I njëjtë vendim kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Ortaku i vetëm i shoqërisë mund të vendosi zvogëlimin e kapitalit themeltar.

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet kontibuteve te reja te pjeseve te kapitalit themeltar me derdhje ne para ose me kontribut ne natyre.

Vendimi per zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqerise i njoftohet QKB-se dhe publikohet ne faqen e internetit te Shoqerise.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 8 **FUNKSIONET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**


Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë datë 14.4.2008 PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm registrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen

TITULLI III

ADMINISTRATORI/ËT

NENI 9 **EMËRIMI I ADMINISTRATORIT**



Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë për pesë vjet.

Administrator i shoqërisë “**Banesto Limited AL**” sh.p.k, do të jenë të dy partnerët:

Z.Firus Motin Miah, lindur më 03.05.1985 në Cumilla,Bangladesh dhe banues të përkohshëm në Tiranë në adresën: Rr.”Elbasanit”,Pl.2,Ap.26 Tiranë, Tel. +355 68 365 6983; E-mail: alina21966@yahoo.com , madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse I pasaportës nr. EA0630340, me një kohëzgjatje të ushtrimit të detyrës për pesë vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Z.Abdul Ahmed Ali, lindur më 03.10.1966 në Sylhet,Bangladesh dhe banues të përkohshëm në Tiranë në adresën: Rr.”Elbasanit”,Pl.2,Ap.26 Tiranë, dhe rezident ne Spanjë me nr. E22517751,madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse I pasaportës nr. BN0436128; tel. +34 632 70 34 66, me një kohëzgjatje të ushtrimit të detyrës për pesë vjet, me të drejtë ripërtëritje.

NENI 10 KOMPETENCAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

1.Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori i cili mund t'i ushtroj të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme apo nga Ligji.

- a) kryen të gjitha veprimet e administritimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të përfaqësoje shoqerine ne bankat dhe institucionet financiare brenda dhe jashtë Shqipërisë, dhe ai ka e drejta për të hapur llogari për kompaninë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Administratori ka të drejtë të përfaqësoje shoqerine në te gjitha institucionet shteterore apo private brenda dhe jashtë shqiperise, te zgjedhi avokat, apo te autorizoje persona te trete per perfaqsim kur e lejon ligji.

Ai gjithashtu ka të drejtë të krijojë një ekip teknik, administrativ,ligjor dhe finansiar dhe të miratojë ose refuzojë të emërojë çdo person që ai e konsideron të papërshtatshëm për të kryer

kérkesat e punës, dhe ai ka të drejtë të nënshkruajë kontrata për emërimin e punëtorëve ose të përfundojë shërbimi i çdo punonjësi (ve).

TITULLI IV DIVIDENDËT DHE KAPITALIZIMI I FITIMEVE

NENI 11 DIVIDENDËT

Pas përmbusjes së kérkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.

Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshmëri në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.

Nëse një dividend nuk është térhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të térhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë.

TITULLI V PRISHJA DHE NJOFTIMET NENI 12 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakut/ve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

NENI 13 NJOFTIMET

Njoftimet që u bëhen ortakëve ose që bëjnë personat sipas Statutit duhet të jenë me shkrim me letër rekomande me marrje përgjigje në adresat respektive ose me post elektronike (e-mail).

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË “BANESTO LIMITED AL ” SH.P.K

Z.Firus Motin Miah

FIRUS. MIAH
FIRUS MIAH

Z.Abdul Ahmed Ali

ABDUL AHMED ALI
abdul ahmed ali